REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 06/17
Data/Datum. 10.01.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E PEJES**

Për Aktivitetin e Prokurimit: PE635-16-113-2-2-1

Sa i përket tenderit për:**"MIREMBAJTJA DIMERORE E RRUGEVE NE KOMUNEN E PEJES"Lot1,Lot2 ,Lot 3** Lot - 1

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*
ER-LIS SHPK & VE-MOR SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Rozhajës, nr 54

(Adresa)

Peje ***30000***

(Vendi)(Kodi postar)

044111 305

(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)

Shpetim Morina

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

shpkerlis@gmail.com

(Adresa elektronike)

10.01.2017

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

S.H.P.K. ER-LIS 601528211 Pejë, Vitomiricë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. 2. Identifikimi
Ankesa parashtrohet permes përfaqësuesit te OE "ER-LIS" sh.p.k.

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë"apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit",nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Nr. i Prokurimit: PE635-16-113-2-2-1
Lloji i kontratës: 2 - Shërbime
Data e publikimit: 06-Dec-2016
Data e skadimit: 15-Dec-2016
Titulli i shpalljes:"MIREMBAJTJA DIMERORE E RRUGEVE NE KOMUNEN E PEJES"Lot1,Lot2 ,Lot 3
Njoftim per informata shtese dat:13.12.2016 dhe 14.12.2016
Njofim per dhenje : Leter standarde per tenderuesin e eliminuar
Kerkese per Rishqyrtim 27.12.2016
Qasje ne dokumente zyrtatre 27.12.2016
Pergjigji ne kerkesen per Rishqyrtim : 29.12.2016

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Njoftimin për eliminim nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitet të prokurimit LIDERI i konzorciumit ER-LIS shpk nuk është informuar por anetari i konzorciumit Ve-Mor shpk

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Në cilësi të palës së interesuar që ka interes juridik-material, lidhur lidhur me këtë aktivitet prokurimi OE ER-LIS SHPK & VE-MOR SHPK kemi bere ankesë per rishqyrtim e cila është dorëzuar brenda afateve kohore.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apoNjoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

ER-LIS SHPK & VE-MOR SH.P.Knë cilësi të palës së interesuar që ka interes juridik-material, lidhur me këtë aktivitet prokurimi, vlerëson se Autoriteti Kontraktues, ka bërë shkeljet e dispozitave ligjore te LPP-se si dhe legjislacionit dytësor, rregullave të prokurimit si vijon:

1) **Neni 1 te Ligjit Nr.04/L-042, Qëllimi;**
2) **Neni 6 te Ligjit Nr.04/L-042, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;**
3) **Neni 7 te Ligjit Nr.04/L-042, Barazia në Trajtim / Jo Diskriminim;**
4) **Neni 59 i LPP-së nr.04/L-042, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;**
5) **Neni 60.1.1 të LPP-së nr.04/L-042, Kriteret për Dhënien e Kontratës;**
6) **Neni 69 i LPP-së nr.04/L-042, Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;**
7) **Neni 54 -Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar**
8) **Neni 3.4 i Udhëzimit Operativ për Prokurimin Publik**
9 **Neni 24,paragrafi 24.1 pika C** i Udhëzuesit për Prokurimin **Publik "Grup i Operatorëve Ekonomik"**
10) **Neni 17 paragrafi 1 i Rregulloresse Prokurimit Publik**

1. Autoritetet kontraktuese mund të përdorin vetëm kërkesa, kritere dhe specifikacione të publikuara ose parashtruara në dosjen e tenderit gjatë përzgjedhjes së tenderëve dhe dhënies së kontratës. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë procedurës së prokurimit.

** *Sipas Nenit 118të LPP, OSHP-ja do të kthejtarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenëte rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Rrethanat faktike:

AK nuk e ka respektuar Ligjin e Prokurimit Publik ka veprur njeanëshem edhe pse Konzorciumi ER-LIS & VE-MOR i ka permbushur te gjitha Kerkesat e kerkuara ne dosjen e tenderit dhe ne FDT.
Kurse Operatoret e propozuar për shpërblim me Kontratë kanë dështuar të përmbushin Kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe sqarimet-informatat e AK te dates 13 dhe 14.12.2016 lidhur me këtë Aktivitet të Prokurimit.

Kërkesat e dosjes së tenderit janë:

9.1 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

1. ***Sherbime të ngjajshme në tri vitet e funidit 2013,2014 dhe 2015 për***
   LOTO 1 ka me qene jo me pak se 140,000.00 €.
   LOTO 2 ka me qen jo me pak se 200,000.00 €
   LOTO 3 ka me qen jo me pas se 45,000.00 €
1. ***Lista e Mjeteve të punës për (LOT 1)- (LOT-2)-(LOT-3)***

9.2 Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Lista e sherbimeve të ngjajshme e vërtetuar nga OE-origjinal,,ku përfshihen titujt e projekteve,numri,data e kontraktimit dhe vlera, të bashkangjitur te jen referencat ose procesverbalet te pranimit.Për LOTO -1, LOTO -2 ,LOTO- 3

2. Lista e pajisjeve – mjeteve te punës qe OE duhet ti ketë në dispozicion(në pronsi te vetën) të dëshmohen me kopje te librezave, deklarate doganore apo ndonjë dëshmi tjetër, të specifikuar për LOTO'n <u>për të cilen paraget kërkes</u>

Nr.	MAKINERITLOT-1	SASIA
1	*Kamion borëpastrues*	3
2	*Makineri të leht për pastrimin e trotuareve dhe shesheve*	1
3	*Makineri të leht (Skip) për ngarkimin e borës në kamion*	1
4	*Makineri të rëndë (Ult)dhe këtë makineri nuk mund ta shfrytëzoi për mirmbajtjen dimërore*	1

Nr.	MAKINERITLOT-2	SASIA
1	*Kamion borëpastrues*	3
2	*Makineri të leht (Skip) për ngarkimin e borës në kamion*	1
3	*Makineri të rëndë (Ult)dhe këtë makineri nuk mund ta shfrytëzoi për mirmbajtjen dimërore*	1

Nr.	MAKINERITLOT-3	SASIA
1	*Kamion borëpastrues*	3
2	*Makineri të rëndë (Ult)dhe këtë makineri nuk mund ta shfrytëzoi për mirmbajtjen dimërore*	1
Vrejtje1: *Preferohet që O.E gjatë gjith kohës së mirmbajtjes dimërore makinerit ta ketë në Rugovë për shkak të reshjeve të mëda dhe të shpeshta dhe se orët e punës do të llogariten vetëm orët efektiv dhe nuk do të llogariten orët nga vendodhja e operatorit deri tek rrugët që do të mirmbahen.*		

Vrejtje 2:*A.K për shkakë të efikasitetit të punëve O.E do ti shpërblejë vetëm me një LLOT*

- Autoriteti Kontraktues dhe Komisioni Vleresues kan bërë shkelje duke nënshkruar raportet e vleresimit për secilin LOT dhe per secilin OE që ka konkuruar dhe atë që të gjithë (me perjashtim te 1 OE) duke i shpallur si të përgjegjeshem, duke mos përfill kërkesat e Dosjes së tenderit dhe informatat shtesë (sqarimet) e bëra nga vetë AK lidhur me dëshmitë e kerkuara dokumentare. Ku kerkohet që makineria e perdorur per një LOT nuk mund te perdoret per LOTIN tjeter.

Sqarim: OE kane konkuruar ne dy ose ne tri Lote dhe për të gjitha llotet komisioni i ka vlerësu si të përgjegjëshëm dmth OE per dy/tri Llote duhet të kene paisje (në pronesi):

1. **Kamion borëpastrues:** 6 cope per dy(2) Lote /9 per tri(3) Lote
2. **Makine e lehte per pastrim te trotuareve dhe shesheve**1 cope

3. **Makineri të leht (Skip) për ngarkimin e borës në kamion**2 cope
4. **Makineri të rëndë (Ult)dhe këtë makineri nuk mund ta shfrytëzoi për mirmbajtjen dimërore** 2cope/3

Te gjitha këto janë sqaruar në sqarimet e pranuara nga Ak

- Deshmi shkresat nga Autoriteti kontraktues dat. 13 dhe 14.12.2016

Gjatë qasjes në dokumente Zyrtare kemi hasë në parregullsi të cilat AK nuk i ka cilësuar si të tilla:

OE te propozuar per Lot 1 i mungon:

1. **Deklarata e Konzorciumit sipas FDT-së**
   Krijimi i njëgrupi te operatorëve ekonomik 11.1 pika C.
   Ne kundershtim me kerkesat e dosjes se tenderit e po ashtu ne kundershtim me UO 24.1,C
2. **Dëshmia e kërkuar dokumentare 9.2**
   Pika 1. Lista e sherbimeve të ngjajshme e vërtetuarnga OE-origjinal,.....,ku përfshihen titujt e projekteve,.....Për LOTO -1, LOTO -2 ,LOTO- 3
   OE nuk e permbush deshmit e kerkuara dokumentare sipas kerkesave te dosjes se tenderit.
3. **Pika 2. Lista e pajisjeve** – mjeteve te punës qe OE duhet ti ketë në dispozicion(në pronsi te vetën) .....,të specifikuar për LOTO'n për të cilen paraqet kërkes
   Po ashtu OE deshton te dëshmoj listen e paisjeve te specifikuara ne Dosjen e Tenderit

- Pra OE e propozuara per Kontratë dështojnë të paraqesin dokumentet e kërkuara nga AK si dhe në kundërshtim me LPP-në,Komisioni Vleresues nënshkruan Raportin e Vlerësimit i cili nuk është i vërtet, kurse AK i shpallë si të përgjegjëshme përkundër Informatave shtesë dhe kërkesave të dosjes së tenderit të bëra nga vetë AK.
- Po ashtu edhe në Kerkesen për Rishqyrtim kemi njoftuar Autoritetin Kontraktues për shkeljet e bëra gjatë vlerësimit, në përgjigjen e AK anashkalon gjdo përgjigje e cila ka të bëjë me kërkesat e dosjes së tenderit.

- Nga Zyrtarët e Prokurimit kemi edhe dëshmi me shkrim për të gjeturat e operatorëve të propozuar për kontratë por Çuditërishtë AK nuk ndërmerr asgjë për të respektuar Ligjine LPP-së

- Komisioni Vlerësues mendoj që ka bërë shkelje,(duke nënshkruar Deklaraten nën Betim)morale e ndoshta edhe penale lidhur me nënshkrimin e vlerësimit të rrejshëm ose të gabuar në kundërshtim me:

Neni 59 te LPP-së
Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

1. Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e **Komisionit Vlerësuesmarrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës.**

2 Po ashtu AK ka bere shkelje të nenit Neni 16 paragrafi 2.3. te RREGULLORES SE PROKURIMIT PUBLIK

Krijimi i Komisioneve të Vlerësimit

Ne dosjen e Tenderit AK :
Vrejtje 2:*A.K për shkakë të efikasitetit të punëve O.E do ti shpërblejë vetëm me një LLOT*
Që do të thotë se të gjithë OE do të shpërblehen vetëm me një Kontratë , e në rastin tonë nëse njëri nga OE e propozuara për Kontratë eshtë i papërgjegjëshëm atëher ne shpërblehemi me kontratë.

PROPOZIM

OSHP-së i propozojmë që me rastin e shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga OE ER-LIS &VE-MOR- PEJË lidhur me aktivitetin e prokurimit Nr.PE635-16-113-2-2-1
Sa i përket tenderit për: "MIREMBAJTJA DIMERORE E RRUGEVE NE KOMUNEN E PEJES"Lot1,Lot2 ,Lot 3

të nxjerr **vendim**:

APROVOJË si të bazuar ankesën e OE ER-LIS shpk& VE-MOR-shpk

ANULOJ: Vendimin – Njoftimi për DHENIE TE KONTRATES

URDHËROHET: AK, KOMUNA E PEJES ta kthej ne RI Vlersim Aktivitetin e Prokurimit
"MIREMBAJTJA DIMERORE E RRUGEVE NE KOMUNEN E PEJES"Lot1,Lot2 ,Lot 3 NRP PE635-16-113-2-2-1

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzimet e pergatitjes se dosjes se tenderit ato te sigurimit te tenderit, fitimin e humbur,humbjen e kohës, dëmtimin e imazhit të kompanisë , pergaditja e makinerise, stafit për fillimin e puneve, etj.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

c) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

d) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

e)Kerkese per Rishqyrtim 25.10.2016

f) Pergjigji ne kerkesen per Rishqyrtim 29.10.2016

g) Njoftim per dhenjen e Kontrates 29.10.2016

****Sipas Nenit 111.2 të LPP,Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

DESHMIT E DOREZUARA:

1. *Raportet e komisionit vlerësues për të gjithë operatorët*
2. *RAPORTI I VLERESIMIT TE TENDEREVE –*
   - Lista e plotë STANDARDE PËR PËRSHTATSHMERINË ADMINISTARTIVE të TENDERËVE
3. *Lista e të gjeturave gjatë qasjes ne dok. Zyrtare e nënshkruar nga Zyrtari i Prokurimit*
4. *Marrveshjet e konzorciumit në kundërshtim me FDT-në Neni 11.1 pika C "një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilëtautorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit,*
5. *Lista e sherbimeve të ngjajshme (kopje) – në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit 6.*
   *Lista e paisjeve **kopje dhe e pa nenshkruar e pa vertetuar** në kundershtim me Kerkesat e Dosjes së tenderit*
7. *Lista e kontratave te ngjajshme, Operatoret e propozuar për kontratë nuk e kan fare.*